

AKT-THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" BALILI-KO"SH.P.K.

Sot me daten 15/11/2001 ne Sarande une i quajtur Bashkim Balili, i biri i Sabaudinit, i datelindjes 1962, lindur ne Delvine dhe banues ne Stjar me deshiren time mora vendimin qe te krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emrin "BALILI-KO"SH.P.K., qendra e se ciles do te jete ne qytetin e Delvines, por me kalimin e kohes selia mund te ndrroj shoqe me pelqimin e ortakut te vetem.

Veprimtaria e shoqerise do te konsistoje ne ushtrimin e aktivitetit privat per sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridik qe ushtrojne veprimtari ne Republiken e Shqiperise, sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe te shendetit te personave fizik, shtetas shqiptare ose te huaj

Ushtrimi i veprimtarise se shoqerise do te jete ne te gjithe vendin.

Kete aktivitet aktualishte do ta ushtroje si ortak i vetem dhe administrator i vetem me mendimin qe ne vazhdimesi te caktoj administrator. Kapitali fillestar i shoqerise do te jete 4.000.000 leke.

Bazuar ne ligjin nr.8770 date 19/04/2001 drejtues teknik i shoqerise duke qene se i ploteson te gjitha kerkesat e ligjit caktohet zoti Latif Kullaj.

Kete akt-themelimi e mbeshtes ne ligjet nr.7512 date 10/08/1991, nr.7638 date 19/11/1992 "Per shoqerite tregtare", nr.7667 date 28/01/1993 "Per regjistrin tregtar" si dhe ne ligjin nr.8770 date 19/04/2001 "Per sherbimin e ruajtjes dhe te sigurise fizike".

Mbasi te regjistrohem si person juridik ne Gjykaten e rrethit Tirane dhe ne zyren perkatese tatimore do te zhvilloje veprimtarine private sipas objektit te shenuar ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise dhe te percaktuar ne vendimin perkates te Gjykates si person juridik.

Ne aktivitetin tim ne kete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar do ti permbahem statutit te hartuar per kete qellim dhe do te respektoj dispozitat ligjore ne fuqi ashtu edhe ato qe do te dalim me vone per veprimtarine private te shoqerive tregtare.

Ky akt themelimi u redaktua ne kater kopje, nga te cilat njeren e mban Gjykata e rrethit Tirane, nje kopje i lihet zyres noterjale, kopja



e trete dorezohet ne zyren perkatese te tatimeve dhe kopja e katert
doz te mbahet nga une themeluesi i kesaj shoqerie.

Akti i themelimit nenshkruhet nga une rregullishte ,themeluesi i
kesaj shoqerie Bashkim Balili.

ORTAKU I VETEM I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME
PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BALILI-KO"SH.P.K.

BASHKIM BALILI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA DELVINE

NR. 682 REP.
NR. 352 KOL.


V E R T E T I M

Sot me daten 15/11/2001 para meje noterit te noterise Delvine
Shkelqim Haxhiu u paraqite personalishte Bashkim Balili, i njohur prej
meje i cili deklaroi se sa me siper eshte shkruar me deshiren e tij
dhe firmosi.

Une noteri vertetoj firmen e vene para meje konforme ligjit.

N O T E R I

SHKELQIM HAXHIU





S T A T U T

I SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" BALILI-KO" SH. P. K.

Ne mbeshtetje te ligjit nr.7512 date 10/08/1991, ligjit nr.7638 date 19/11/1992 "Per shoqerite tregtare", ligjit nr.7667 date 28/01/1993 "Per regjistrin tregtar" dhe ligjit nr.8770 date 19/04/2001 "Per sherbimin e ruajtjes dhe te sigurise fizike", une i quajtura Bashkim Balili si themelues i shoqerise i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emrin "BALILI-KO"SH.P.K. sot me daten 15/11/2001 duke pasur edhe zotesi te plote juridike per te vepruar shpall persa vijon:

"FORMOHET SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BALILI-KO"SH.P.K. ME THEMELUES ORTAKUN E VETEM BASHKIM BALILI".

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "BALILI-KO"SH.P.K. me themelues z.BASHKIM BALILI, I BIRI I SABAUDINIT, I DATELINDJES 1962, BANUES NE STAAR TE RRETHIT DELVINE.

QENDRA E SHOQERISE

NENI 2

Qendra e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar fillimishte do te jete te ne qytetin e Delvines, por me kalimin e koheselia mund te ndryshoje si brenda ashtu edhe jashte rrethit me pelqimin e ortakut te vetem.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

NENI 3

Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj 30 vjet te njepasnjeshem, por ajo mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per çdo shkak nga ortaku i vetem.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

NENI 4

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "BALILI-KO"SH.P.K. do te kete si objekt te veprimtarise se saj ushtrimin e aktivitetit privat per sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizik e juridik, qe ushtrojne veprimtari ne Republikën e

Shoqërisë, sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave fizik, shtetas shqiptarë ose të huaj.

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 5

Kapitali i shoqërisë fillimisht do të jetë 4.000.000 leke, kontribut i vetë themeluesit të shoqërisë.

Kapitali i kësaj shoqërie me përgjegjësi të kufizuar do të shtohet ose do të pakesohet me kalimin e kohës sipas vendimeve që do të marrë pronari i saj.

NENI 6

Kapitali themeltar i ortakut të vetëm është lirishtë i transferueshem edhe në rast ndarjeje pasurore në mes bashkeshortëve si dhe në rrugë trashëgimie. Gjithashtu janë lirishtë të transferueshme ndërmjet bashkeshortëve si dhe ndërmjet pasardhësve dhe përardhësve.

Me vullnetin e ortakut kapitali themeltar mund të transferohet edhe personave të tretë.

Në rast vdekjeje të ortakut të vetëm të shoqërisë trashëgimtarët e tij mund të vendosin për likuidimin e shumës së kapitalit themeltar ose për vazhdimin e veprimtarisë duke respektuar rregullat e nenit 46 të ligjit "Për shoqëritë tregtare".

ASAMBLEA

NENI 7

Ortaku i vetëm ushtron gjithë kompetencat që ligji nr.7638 datë 19/11/1992 i ka dhënë Asamblese së ortakëve.

Vendimet e ortakut të vetëm janë të detyrueshme për administratën dhe personelin e shoqërisë, kur këto janë marrë konformë ligjit dhe statutit.

NENI 8

Ortaku i vetëm ka të drejtë:

-Të emerojë dhe të shkarkojë administratën.

-Të informohet në çdo kohë për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njikët me llogarinë dhe dokumentacionin e saj.

-Të vendosë për kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me ekspert të caktuar prej tij.



-Te jape aprovim financiar per çdo veprim financiar qe mund te kryhet nga administratori ne vleren mbi 500.000 laka.

-Te drejta te tjera qe parashikohen nga ligji per shoqerite tregta

ADMINISTRIMI

NENI 9

Shoqeria do te administrohet nga vete pronari ose nga nje administrator i zgjedhur nga ortakut i vetem me afat kohe deri ne nje vit por me te drejte rizgjedhjeje. Drejtuesi i pare teknik do te jete Latif Kullaj.

NENI 10

Administratori ka te drejte:

-Te perfaqesoje shoqerine ne te gjitha marrëdhëniet e saj juridike dhe administrative brenda kompetencave te tij.

-Te kryeje çdo veprim qe e gjykon te arsyeshem dhe konform me ligjin

-Te jape urhdera dhe udhezime personelit te shoqerise dhe te vendose sanksione ndaj tyre ne perputhje me ligjin dhe kontratat e punes.

-Te angazhoje shoqerine ne marrëdhënie me te tretet nepermjet veprimeve qe jane ne perputhje me objektin dhe strategjine e shoqerise

-Te pranoje dhe te largoje nga puna brenda shoqerise punemarres ne perputhje me dispozitat ne fuqi, brenda nevojave dhe organikes se percaktuar.

NENI 11

Administratori ka per detyre:


-Te punoje, te drejtoje e te organizoje ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomiko-financiare.

-Te zbatoje vendimet e marra nga ortakut i vetem dhe urhderat e tij te dhena brenda kompetencave te percaktuara nga statuti dhe legjislatiçioni ne fuqi.

-Te paraqese ne menyre te rregullte raportin e administrimit, inventarin e bilancin dhe llogarite vjetore ortakut te vetem brenda afatit prej gjashte muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

-Te pergjigjet ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve per shkeljet ligjore, per shkeljet e statutit te shoqerise si dhe per fajet e kryera gjate administrimit.



 -Te drejta te tjera dhe detyrime te percaktuara nga ligji per shoqerite tregtare.

NENI 12

Per perfaqesimin e shoqerise perpara organeve administrative, gjyqesore ose te treteve duhet firma e administratortit.

NENI 13

Ne rast pengesash si semundje, aksidente, udhetime te administratortit e tjera ortakut i vetem ka te drejten e zevendesimit te perkohshem te tij.

NENI 14

Vula e shoqerise do te kete forme te rrumbullaket ne te cilen eshte shkruar:

"REPUBLIKA E SHQIPERISE. SHOQERIA ME PERGJEGJESSI TE KUFIZUAR
"BALILI-KO" SHPK. SARANDE. ALBANIA".

NENI 15

Shoqeria vepron ne regjim te punes private dhe merr persiper te drejta dhe detyrime. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore dhe jashte kontraktore brenda kapitalit te saj te fituar.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 16

Veprimet mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti, perveç urhderave te veçanta qe jep pronari per kete qellim. Administratori nxjerr bilancin me te ardhurat, fitimet, humbjet te formuluar konforme ligjit.


NENI 17

Eshte kopetence e ortakut te vetem te vendose per krijimin e fondeve nga te ardhurat neto si dhe per perdorimin e tyre.

SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 18

Duke qene se ne çdo kohe dhe per motive te ndryshme shoqeria mund te ndodhet perballe shperberjes, ortakut i vetem mund te vendose per menyren e likujdimit te saj ne baze te ligjeve ne fuqi. Ai vendos per likujdimin nje ose me shume likujdatore duke u percaktuar dhe detyrat.



NENI 19

Shoqeria private do te kete numrin e saj te llogarise rrjedhese regjistruar ne Banken e Shtetit shqiptar ne Serande.

MARRJA NE PUNE E ROJEVE, KRITERET QE DUHET TE PLOTESOJNE.

NENI 20

Per personat qe do te mirren ne pune ne kete shoqeri do te lidhet kontrate e rregulite pune duke respektuar KODIN E PUNES, ligjin nr. 8770 date 19/04/2001 dhe udhezimin e Ministrise se Rendit Publik.

NENI 21

Ne çeshtjet organizative shoqeria do te mirret vete me zgjedhjen e personave qe do te mirren ne pune civile dhe jo kalon per miratim organeve te rendit publik per dhenien e licenses se ushtrimit te profesjonit. Drejtuesi teknik eshte drejtuesi me i larte teknik dhe pergjegjesi ligjor per drejtimin, bashkerendimin dhe kontrollin e sherbimit.

NENI 22

Ne sherbimin e rojeve civile pranoen persona fizike qe plotesojne keto kushte:

- 1-Te jene shtetas shqiptar.
- 2-Te kene mbaruar arsimin e detyruar.
- 3-Te kene kryer sherbimin ushtarak.
- 4-Te mos jene denuar per krime kunder pasurise shteterore, private, per krime kunder moralitet dhe krimin e vrasjes.
- 5-Te plotesojne kushtet shendetesore dhe fizike.

NENI 23

Sherbimi i rojeve civile qe punojne ne firme organizohet nga shoqeria e krijuar posaçerishte per kete qellim te pajisur nga organet kompetente te rendit publik qe veprojne ne njesi te caktuara administrative.

NENI 24

Numri i efektivit qe puneson shoqeria percaktohet ne marreveshje me organet e rendit publik, por gjithnje me pak se 5% (pese perqind) te efektivit te policise se qarkut te njesise administrative ku punon.

NENI 21

Shoqeria do te lidhe kontrate me organet e rendit per pajisjen me armatim te personave qe do te punesohen si dhe per aftesimin e tyre profesional

NENI 22

Shoqeria do te hartoje rregulloren per te drejtat dhe detyrat e paleve per ruajtjen e objekteve, per sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe shendetit te personave fizik dhe per shoqerimine vlerave materjale dhe te sendeve te cmuara gjate transportimit te tyre.
Rregullorja pasi do te hartohet do te miratohet nga administratori dhe drejtuesi teknik.

NENI 23

Shoqeria do te lidhe kontrata me persona fizike dhe juridik shqiptar ose te huaj per ruajtjen e tyre ose te objekteve
Ne kontrate do te percaktohet me hollesi per te drejtat dhe per detyrimet e paleve.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 24

Persa nuk eshte shprehur ne statut vlejne dispozitat ligjore dhe konkretishte ligjin nr.7638 date 19/11/1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligji nr.8770 date 19/04/2001 "Per sherbimin e ruajtjes dhe te sigurise fizike". si dhe aktet e tjera ligjore qe rregullojne kete veprimtari.

NENI 25

Ky statut eshte redaktuar ne kater kopje nga te cilat njeren kopje e mban Gjykata e rrethit Tirane ku behet edhe regjistrimi, nje kopje lihet ne zyren noterjale, kopja e trete lihet ne tatime dhe kopja e katert do te mbahet nga une pronari dhe themeluesi i kesaj shoqerie. se bashku me aktet e tjera.

Statuti i miratuar nga ortaku i vetem nanshkruhet rregullishte prej tij.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE ME PERGJEGJESI
TE KUFIZUAR "BALILI-KO" SH.P.K.

BASHKIM BALILI

REPUBLIKA SHQIPERISE
NOTERIA DELVINE

NR. 682 REP.
NR. 395 KOL.

V E R T E T I M

Sot me daten 15/11/2001 para meje noterit te Delvines Shkelqim Haxhiu u paraite personalishte Bashkim Balili, i njohur prej meje, i cili deklarojn se sa me siper eshte hkruar me deshiren e tij dhe firmosi.
Une noteri vertetoj firmen e vene para meje konforme ligjit.

NOTERI
SHKELQIM HAXHIU